

## **Rregullat e lojës shpërblyese “Coca-Cola Super Lojë Shpërblyese”**

### **Neni 1: Emri dhe selia e shoqërisë tregtare**

Organizatori i lojës shpërblyese “Coca-Cola Super Lojë Shpërblyese” është "MMS Komunikacii Makedonija DOO Skopje/MMS Komunikime Maqedoni SHPK Shkup /", me seli në rrugën Franklin Ruzvelt 37/3, 1000 Shkup dhe NUI MK4030996253997 (në tekstin vijues Organizatori).

Organizatori është ekskluzivisht përgjegjës për zbatimin administrativ, teknik dhe organizativ të lojës shpërblyese, përkatësisht të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara ligjërisht të Organizatorit të lojës shpërblyese. Organizatori nuk mban përgjegjësi për cilësinë, shfrytëzimin ose pamundësinë eventuale të përdorimit të çmimeve.

### **Neni 2: Shërbimet dhe produktet për reklamimin e të cilave organizohet loja shpërblyese**

Qëllimi i lojës shpërblyese të organizuar nga "MMS Komunikacii Makedonija DOO Skopje" është reklamimi i produkteve të Birrarisë së Shkupit SHA (Porositësi i lojës shpërblyese). Porositësi i lojës shpërblyese siguron mjetet, përkatësisht çmimet që ndahen në kuadër të lojës shpërblyese.

### **Kohëzgjatja e lojës shpërblyese**

Loja shpërblyese fillon më **18.05.2026** vit, në orën 12:00 dhe zgjat deri më **26.08.2026** deri në orën 12:00.

Në periudhën nga **18.05.2026** në orën 12:00 deri më **22.07.2026** vit deri në orën 23:59', në lojën me çmime marrin pjesë paketimet e mëposhtme promovionale, të shënuara posaçërisht si çmime:

- **Coca-Cola dhe Coca-Cola Zero nga 450 ml në ambalazh plastik** me paketim promovional, të shënuar posaçërisht si çmim, të cilat kanë kod nën kapakun e bardhë promovional;
- **Kanaçe Coca-Cola dhe Coca-Cola Zero nga 330 ml** me paketim promovional, të shënuar posaçërisht si çmim, të cilat kanë kod nën hapësin e kanaçes;
- **Coca-Cola dhe Coca-Cola Zero nga 250 ml në ambalazh qelqi** me paketim promovional, të shënuar posaçërisht si çmim, të cilat kanë kod në anën e brendshme të etiketës së pasme;

Në periudhën nga **23.07.2026** në orën 00:00' deri më **26.08.2026** vit deri në orën 12:00 në lojën me çmime marrin pjesë:

- **Coca-Cola dhe Coca-Cola Zero nga 250 ml në ambalazh qelqi** me paketim promovional, të shënuar posaçërisht si çmim, të cilat kanë kod në anën e brendshme të etiketës së pasme;

### **Neni 3: Emri, përshkrimi dhe kohëzgjatja e lojës shpërblyese**

Emri zyrtar i lojës shpërblyese është “Coca-Cola Super Lojë Shpërblyese”.

Të drejtën e pjesëmarrjes në lojën shpërblyese kanë të gjitha personat fizikë madhorë, banorë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët pranojnë dhe plotësojnë kushtet e këtyre rregullave (Pjesëmarrësit).

Loja shpërblyese do të zhvillohet nëpërmjet aplikacionit celular Coca-Cola dhe do të ndahen çmime ditore nëpërmjet fitimit të çastit nëpërmjet të ashtuquajturve momentet fituese (winning moments) dhe shorteut (lucky draw). Kushti për fillimin dhe pjesëmarrjen në Lojën shpërblyese është që konsumatori të blejë ndonjërin nga produktet e listuara në nenin 2 të këtyre Rregullave.

### **Aplikacioni**

Për t'u bërë pjesëmarrës në Lojën shpërblyese, konsumatori duhet të shkarkojë aplikacionin Coca-Cola, të krijojë profilin e tij dhe të fusë kodin nga ana e brendshme e etiketës, nga nën kapakun ose nën hapësin e kanaçes nga Produktet që marrin pjesë në lojën shpërblyese, në periudhën e dhënë, të cilat janë të listuara në nenin 2 të këtyre Rregullave.

Aplikacioni Coca-Cola mund të shkarkohet falas nga Google Play Store për pajisjet me sistem operativ Android ose nga Apple Store për pajisjet me sistem operativ iOS (në tekstin vijues: "Aplikacioni").



Aplikacioni ka ikonën e mëposhtme

Aplikacioni mund të shkarkohet edhe drejtpërdrejt duke skanuar QR kodin që është vendosur në paketimet e produkteve që marrin pjesë në Lojën shpërblyese dhe materialet reklamuese në pikat e shitjes ku shiten ato produkte.

Me shkarkimin e aplikacionit, konsumatori duhet të konfirmojë se i pranon kushtet e tij.

Për të mundur pjesëmarrësi të krijojë profil, është e nevojshme të fusë në aplikacion të dhënat e mëposhtme: emrin e përdoruesit, adresën e vlefshme të e-postës, shtetin dhe datën e lindjes. Të gjithë përdoruesit e aplikacionit Coca-Cola, të cilët e kanë instaluar tashmë dhe kanë krijuar profilin e tyre, me futjen e kodit nga ana e brendshme e etiketës, nga nën kapakun ose nën hapësin e kanaçes nga Produktet e listuara në nenin 2 të këtyre Rregullave, regjistrohen dhe kanë të drejtë të marrin pjesë në lojën shpërblyese dhe i pranojnë kushtet e saj.

### **Kohëzgjatja e lojës shpërblyese**

Loja shpërblyese fillon më

18.05.2026, në orën 12:00 të drekës dhe zgjat deri më 26.08.2026, deri në orën 12:00 të drekës.

Pas përfundimit të lojës shpërblyese (më 26.08.2026 në orën 12:00 të drekës) pushon mundësia e shfrytëzimit të pikëve të mbetura nga ana e pjesëmarrësve në lojën shpërblyese, si dhe mundësia e fitimit të çmimeve.

Të gjitha pikët e gjeneruara gjatë lojës shpërblyese janë të vlefshme ekskluzivisht për këtë lojë shpërblyese. Pas përfundimit të lojës shpërblyese, të gjitha pikët e gjeneruara në profilin e pjesëmarrësit do të fshihen dhe nuk do të ekzistojë mundësia e përdorimit të tyre të mëtejshëm. Pikët e gjeneruara gjatë promociioneve dhe lojërave shpërblyese të mëparshme në aplikacion nuk do të jenë aktive dhe nuk do të mund të përdoren në këtë lojë shpërblyese.

### **Futja e kodeve**

Çdo pjesëmarrës në lojën shpërblyese mund të marrë pjesë duke futur kode nga Produktet që marrin pjesë në lojën shpërblyese, të përshkruara në nenin 2 të këtyre Rregullave, në aplikacionin Coca-Cola të lartpërmendur, për të cilat në aplikacion do të marrë nga 1 (një) pikë në formën e

pikës "Gem". Pikët e grumbulluara, përdoruesi mund t'i shohë në fushën "Informacion mbi gjendjen" të aplikacionit.

Çdo kod i futur, pavarësisht nga cili paketim nga Produktet e listuara në nenin 2 të këtyre Rregullave rrjedh, konvertohet në 1 (një) pikë në formën e pikës "Gem".

Çdo kod është unik (i vetëm) dhe mund të futet në aplikacionin Coca-Cola vetëm një herë. Një pjesëmarrës mund të marrë pjesë në lojën me çmime numër të pakufizuar herësh dhe ka shans të fitojë çmime të ndryshme, por me kode të ndryshme.

Pas futjes së kodit, pjesëmarrësi do të marrë njërin nga njoftimet e mëposhtme, nëpërmjet Aplikacionit:

- Nëse futet një kod i vlefshëm, pjesëmarrësi do të marrë njoftimin: "Sukses! A dëshironi të futni edhe ndonjë kod tjetër?"
- Nëse i njëjti (pra tashmë i përdorur) kod futet herën e dytë, pjesëmarrësi do të marrë njoftimin: "Kodi është tashmë i përdorur."
- Nëse futet një kod i gabuar, pjesëmarrësi do të marrë njoftimin: "Kod i gabuar."
- Nëse futet një kod për të cilin nuk ka promocion aktiv, pjesëmarrësi do të marrë njoftimin: "Kodi nuk është aktiv."

Në periudhën nga 23.07.2026 në orën 00:00' deri më 23.07.2026 deri në orën 12:00' të drekës, për transferimin nga periudha e parë në të dytën të lojës shpërblyese dhe konfigurimin teknik apo sistemor, pjesëmarrësi do të ketë mundësi të fusë kode dhe për to të marrë pikë "Gem", por ato do të mund t'i luajë, respektivisht t'i përdorë pas orës 12:01' më 23.07.2026 deri më 26.08.2026 deri në orën 12:00 kur përfundon loja shpërblyese.

## **Përdorimi i pikëve "Gem"**

### **Momentet fituese (winning moments)**

Çdo pjesëmarrës në lojën shpërblyese pasi të ketë futur kodin dhe të ketë marrë një Gem, mund të marrë pjesë në fitimin e çastit nëpërmjet **momenteve fituese (winning moments)**.

Kur pjesëmarrësi zgjedh të marrë pjesë në mundësinë e fitimit të çastit nëpërmjet momenteve fituese, pikën "Gem" e shfrytëzon duke klikuar fushën e shënuar me "le të provoj fatin tim" në vetë Aplikacionin, me çka do të shfrytëzohet një pikë "Gem". Menjëherë pas kësaj, pjesëmarrësi do të marrë mesazh në Aplikacion nëse pika e shfrytëzuar është fituese apo jo, respektivisht nëse ka fituar çmim. Cilin çmim ka fituar fituesi, mund ta shohë në profilin e tij në Aplikacion.

Me çdo përpjekje për të fituar çmim, pjesëmarrësi humbet, respektivisht shfrytëzon nga një Gem. Pikët Gem, të marra me futjen e kodeve në aplikacionin Coca-Cola, nuk duhet të shfrytëzohen në momentin e futjes, por duhet të shpenzohen deri në fund të lojës shpërblyese (26.08.2026 deri në orën 12:00 të drekës). Pas datës së lartpërmendur, pushon mundësia e shfrytëzimit të pikëve të mbetura.

Fituesit, si dhe çmimet e fituara, përcaktohen me rrugë kompjuterike duke përdorur algoritëm të zgjedhjes rastësore. Algoritmi i zgjedhjes rastësore përcakton momentin fitues dhe pika e parë e shfrytëzuar pas atij momenti bëhet fituese, dhe në atë rast algoritmi përcakton edhe çmimin që do ta fitojë pika "Gem" fituese përcakton edhe çmimin që do ta fitojë pika "Gem" fituese.

### **Shorteu (lucky draw)**

Në shorteun **rastësor (lucky draw)** marrin pjesë të gjitha pikët "Gem" të shfrytëzuara për të cilat pjesëmarrësi nuk ka fituar çmim.

Gjatë shortimit, nga të gjitha kodet e regjistruara për atë short, me zgjedhje rastësore do të shortohen numrat unikë të vauçrëve të cilët do të fitojnë çmim (të përshkruara në mënyrë më të hollësishme në nenin 8 të këtyre Rregullave).

### **Funksionaliteti teknik**

Pjesëmarrja në lojën shpërblyese nënkupton që të interesuarit të kenë qasje në internet (Internet) me mjetet e tyre teknike.

Nëse përdoruesi ka vështirësi të fusë kodin në aplikacion, duhet të ruajë një fotografi të tij dhe të kontaktojë qendrën e kontaktit në numrin e telefonit 02/3207 751 çdo ditë pune nga ora 9:00 deri në orën 17:00, për kontroll dhe ndihmë.

Aplikacionin e administron ekskluzivisht Coca-Cola Services S.A e cila është përgjegjëse për funksionalitetin e tij. Në çdo rast, Porositësi, Organizatori dhe Coca-Cola Services S.A nuk janë përgjegjës për asnjë problem indikativ ose mosfunksionim teknik të rrjeteve ose linjave telefonike, sistemeve kompjuterike online, serverit ose ofruesit, komponentëve kompjuterike, softuerit, pamundësisë për dërgimin ose marrjen e të dhënave për shkak të hapësirës së pamjaftueshme ose për shkak të problemeve teknike ose ndërprerjeve të internetit ose të ndonjë ueb faqeje për shkak të arsyeve që nuk janë në kontrollin e tyre, forcës madhore ose kombinimit të këtyre ngjarjeve, përfshirë edhe shkëputjen e lidhjes me internetin, veprimin e viruseve kompjuterike, veprimet ose ndërhyrjet me qëllim të keq ose të paligjshme të palëve të treta dhe/ose aktivitetet mashtruese të cilat mund të pengojnë ose ndalojnë pjesëmarrjen në Lojën shpërblyese ose për shkak të të cilave pjesëmarrja ose regjistrimi në Aplikacion është i vonuar ose i pamundësuar.

### **Të drejtat e organizatorit dhe porositësit**

Organizatori i lojës shpërblyese ruan të drejtën të refuzojë të gjitha kodet e dërguara të cilat janë fituar në mënyrë jo legjitime, të riprodhuar, të dyfishuar, të shpikur ose të modifikuar në çfarëdo mënyre. Organizatori, respektivisht Porositësi nuk mban përgjegjësi për pengesat teknike të herëpashershme, ndërprerjet e punës së aplikacionit Coca-Cola ose ndërprerjet në trafikun e internetit.

Nëse zbulohet se ndonjë përdorues i Aplikacionit shkel rregullat e pjesëmarrjes ose ekziston dyshimi se po përpiqet të depërtojë në rrjet, sistem ose softuer, pjesëmarrja e tij në Lojën me shpërblyese anulohet menjëherë, me mundësinë e ndërmarrjes ndaj tij edhe të të gjitha masave të tjera të mbrojtjes dhe sanksionit, përfshirë edhe para organeve kompetente.

### **Neni 4: Territori**

Loja shpërblyese organizohet dhe zhvillohet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## Neni 5: Reklamimi

Loja shpërblyese do të reklamohet në mediat elektronike (televizion, radio dhe internet, mediat sociale), mediat e shkruara dhe mediat e tjera, si dhe në vendet ku shiten produktet e listuara në nenin 2 të këtyre Rregullave.

## Neni 6: Fondi i çmimeve

Loja shpërblyese disponon me fond çmimesh prej gjithsej **13.964 çmime** të cilat mund të fitohen, dhe atë:

TABELA ME ÇMIMET

Çmimet			
Lloji i shpërblimit	Sasia	Vlera totale e shpërblimit me TVSH	TOTAL
<b>18.05-22.07</b>			
Top futbollli	3.600	222,72	801.788 den
Çantë sporti	4.100	135,73	556.489 den
Bluzë	600	368,32	220.992 den
Çantë ftohëse	4.600	104,26	479.616,93 den
Mini frigorifer	55	9.303,61	
TV Hisense	6	24.990,04	149.940 den
<b>23.07 - 26.08</b>			
Kufje	400	550,00	219.999 den
Altoparlantë	600	510,00	305.998 den
Altoparlant Marshall	3	17.499,40	52.498 den
<b>TOTAL</b>	<b>13.964</b>		<b>3.299.019 den</b>

Fondi maksimal i përgjithshëm i çmimeve për të gjithë kohëzgjatjen e lojës shpërblyese arrin **3.299.019 denarë**.

Në periudhën nga **18.05.2026** deri më **22.07.2026** në lojën shpërblyese mund të fitohen çmimet e mëposhtme:

- Top futbollli - 3600
- Çantë sportive - 4100
- Bluzë - 600
- Çantë ftohëse - 4600
- Mini frigorifer - 55
- Televizor Hisense - 6 (Karakteristikat: 55", 4K Ultra HD 3840x2160, teknologji QLED, Dolby Vision.Atmos (HDR), AI 4K Upscaler, AI Smooth Motion, GameMode Plus)

Në periudhën nga **23.07.2026** deri më **26.08.2026** në lojën shpërblyese mund të fitohen çmimet e mëposhtme:

- Kufje Genesis Gaming Radon 210 7.1 Backlight USB - 400
- Altoparlant Gembird Bluetooth SPK-BT-15 - 600
- Altoparlant Marshall ACTON III Bluetooth - 3

## **Neni 7: Kushtet e pjesëmarrjes në lojën shpërblyese**

Të drejtën e pjesëmarrjes në Lojën shpërblyese kanë të gjitha personat fizikë madhorë, banorë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët pranojnë dhe plotësojnë kushtet e këtyre rregullave (pjesëmarrësit). Ndalohet pjesëmarrja në lojën shpërblyese për personat të cilët gjatë kohëzgjatjes së lojës shpërblyese janë të punësuar te Organizatori i lojës shpërblyese (MMS Komunikacii Makedonija DOO Skopje), Porositësi (Birraria e Shkupit SHA), NTH Media Maqedoni SHPKNJP Shkup, VORHOL SHPKNJP Shkup, The Coca-Cola Company dhe anëtarët e familjeve të tyre të ngushtë.

Kushti për fillimin dhe pjesëmarrjen në Lojën shpërblyese është që konsumatori të blejë ndonjërin nga produktet e listuara në nenin 2 të këtyre Rregullave në paketim promocional. Në këtë mënyrë, gjatë periudhës së kohëzgjatjes së Lojës shpërblyese dhe nën kushtet e Lojës shpërblyese, të listuara në këto Rregulla, fiton mundësinë të bëhet pjesëmarrës në Lojën shpërblyese.

Me shkarkimin e aplikacionit Coca-Cola dhe pranimin e kushteve të tij, krijimin e profilit dhe futjen e kodit nga ana e brendshme e etiketës, nga nën kapakun ose nën hapësin e kanaçes që janë pjesë e Produkteve të listuara në nenin 2 të këtyre Rregullave, konsumatorët regjistrohen për pjesëmarrje në lojën me çmime.

Me futjen e kodeve nga Produktet që marrin pjesë në lojën me çmime në aplikacionin Coca Cola merren pikë "Gem", të dukshme në fushën "Informacion mbi gjendjen" të aplikacionit.

Rregullat e lojës shpërblyese, mënyra dhe kushtet e pjesëmarrjes në lojën me çmime, si dhe kohëzgjatja e saj, do të publikohen nga Organizatori në faqen web coca-cola.mk, para fillimit të lojës shpërblyese, pas marrjes së miratimit nga Ministria e Financave.

## **Neni 8. Përcaktimi i fituesve në lojën shpërblyese**

Në lojën shpërblyese parashikohet të ndahen gjithsej 13.964 çmime në po aq fitues. Nga këto, 12.961 çmime do të ndahen në periudhën nga 18.05.2026 deri më 22.07.2026, ndërsa 1003 çmimet e mbetura do të ndahen në periudhën nga 23.07.2026 deri më 26.08.2026.

Çmimet nëpërmjet mekanizmit instant **“momentet fituese”** fitohen në mënyrën e mëposhtme:

- Gjatë shfrytëzimit të një pike “Gem” duke klikuar fushën e shënuar me “le të provoj fatin tim” në vetë aplikacionin, pjesëmarrësi menjëherë do të marrë mesazh në ekran nëse pika e shfrytëzuar është fituese apo jo, respektivisht nëse ka fituar çmim. Me çdo përpjekje për të fituar çmim, pjesëmarrësi humbet/shfrytëzon nga një pikë "Gem".
- Gjatë fitimit të çmimit, pjesëmarrësi në profilin e tij në aplikacion mund të shohë cilin çmim ka fituar dhe kodin unik të tij (numri ID i çmimit).
- Fituesit do të përcaktohen automatikisht, pa ndikim të faktorit njerëzor.

- Për ndarjen e çmimeve të parashikuara gjatë çdo dite, me zgjedhje rastësore përcaktohen momentet fituese të cilat ndryshojnë çdo ditë. Fituesit si dhe çmimet e fituara përcaktohen me rrugë kompjuterike duke përdorur algoritëm të zgjedhjes rastësore. Algoritmi i zgjedhjes rastësore përcakton momentin fitues dhe pika e parë e shfrytëzuar pas atij momenti, respektivisht në periudhën nga fillimi i një momenti fitues të caktuar deri në fillimin e momentit të ri fitues, bëhet fituese. Në atë rast algoritmi përcakton edhe çmimin. Të gjithë përdoruesit të cilët do të shfrytëzojnë pikë pas përdoruesit të parë, respektivisht pasi të ndahet çmimi në një moment fitues të caktuar deri në fillimin e momentit të ri fitues, do të marrin mesazh se nuk janë fitues të çmimit.
- Në rast se gjatë momentit aktual fitues nuk është shfrytëzuar asnjë pikë, çmimi i parashikuar për atë moment fitues transferohet në momentin e ardhshëm fitues. Gjithashtu, nëse gjatë momenteve fituese të ditës aktuale nuk ndahen të gjitha çmimet e parashikuara për atë ditë dhe mbeten çmime të pandara, ato transferohen dhe do të ndahen ditën e ardhshme.

Çmimet nëpërmjet mekanizmit **shortimi rastësor** mund të fitohen në mënyrën e mëposhtme:

- Në short marrin pjesë të gjithë përdoruesit e regjistruar të aplikacionit të cilët kanë kryer shkëmbimin e pikës "Gem" me kupon për pjesëmarrje në lojën me çmime dhe nuk kanë fituar çmim instant nëpërmjet mekanizmit të momenteve fituese.
- **Shortimi në lojën shpërblyese do të zhvillohet në dy raunde, më 29.07.2026 në orën 14.00 dhe më 02.09.2026 në orën 14.00.**
- **Në shortin e 29.07.2026 marrin pjesë të gjitha kodet jo-fituese të dërguara në periudhën nga ora 12:00 e datës 18.05.2026 deri në orën 23:59 të datës 22.07.2026.**
- **Në shortin e 02.09.2026 marrin pjesë të gjitha kodet jo-fituese të dërguara në periudhën nga ora 00:00 e datës 23.07.2026 deri në orën 12:00 të datës 26.08.2026.**
- Fituesit përcaktohen automatikisht me rrugë kompjuterike duke përdorur algoritëm të zgjedhjes rastësore, pa ndikim të faktorit njerëzor.
- Në shortin e **29.07.2026** do të shortohen gjashtë fitues nga një televizor Hisense.
- 1. Në shortin e **02.09.2026** do të shortohen 3 fitues nga një altoparlant Marshall nga Tehnomarket.

Në shortin rastësor, do të shortohen edhe nga dy fitues rezervë në rast se fituesi nuk është i disponueshëm në qendrën e kontaktit ose nuk dëshiron ta tërheqë çmimin.

Nëse shfaqet pengesë për ndarjen e çmimit, respektivisht fituesi ka futur të dhëna jo të vlefshme gjatë regjistrimit, brenda **10 ditëve pune** nga dita e shortimit, dhe për çfarëdo arsye, për të cilën nuk do të jetë dhe nuk do të bëhet përgjegjës Organizatori, as Porositësi i lojës shpërblyese, do të konsiderohet se nuk dëshiron ta tërheqë çmimin, ai/ajo humbet të drejtën e çmimit dhe çmimi kalon te fituesi tjetër rezervë.

Çmimet do të shortohen automatikisht, pa ndikim të faktorit njerëzor nga ana e softuerit të krijuar posaçërisht për këtë qëllim të instaluar në ambientet e NTH MEDIA MAQEDONI SHPKNJP SHKUP, me seli në rr. Komuna e Kuqe Shkup p.n., 1000 Shkup. Qendra e të dhënave është e vendosur në adresën e mëposhtme Hardtrumstrasse 161, 8005 Cyrih, Zvicër.

Për zbatimin e lojës shpërblyese do të kujdeset një komision juri me anëtarë të përbërë nga:

- 3) Përfaqësues nga Birraria e Shkupit SHA Shkup;
- 3) Përfaqësues nga "MMS Komunikacii Makedonija DOO Skopje" dhe
- 3) Përfaqësues nga NTH Media Maqedoni SHPKNJP SHKUP

**Pas përfundimit të lojës shpërblyese (më 26.08.2026 në orën 12:00 të drekës) pushon mundësia e shfrytëzimit të pikëve të gjeneruara më parë dhe fitimit të çmimeve.**

### **Neni 9. Publikimi i rezultateve të lojës shpërblyese**

Fituesit e çmimeve do të publikohen në ueb faqen **coca-cola.mk** brenda tre ditëve nga dita e shortimit të çmimeve, respektivisht brenda tre ditëve nga dita e përcaktimit të fitimeve dhe fituesve.

Fituesit e çmimeve, me vetë pjesëmarrjen në lojën shpërblyese, pranojnë që nëse fitojnë ndonjë çmim, adresa e tyre e e-postës me të cilën janë regjistruar në aplikacion (me 5 karaktere të fshehura) dhe çmimi që kanë fituar, të publikohen publikisht në ueb faqen [www.coca-cola.mk](http://www.coca-cola.mk).

Me pjesëmarrjen në këtë lojë shpërblyese, pjesëmarrësit shprehimisht deklarojnë dhe konfirmojnë se janë dakord me mbledhjen, përpunimin dhe transferimin e të dhënave të tyre personale në mënyrën e përshkruar në këto Rregulla. Qëllimi i përdorimit dhe transferimit të të dhënave personale të sipërcituara nga ana e Organizatorit është ekskluzivisht të ndihmojë në zbatimin dhe administrimin e pjesëmarrjes në lojën shpërblyese, respektivisht për ndarjen e çmimit. Me pjesëmarrjen në Lojën shpërblyese dhe pranimin e këtyre rregullave, fituesi pranon që të dhënat e dorëzimit (kodi unik i çmimit, emri, mbiemri, numri i telefonit të kontaktit, e-posta dhe adresa e dorëzimit), respektivisht këto të dhëna personale, t'i dërgohen personit juridik (shërbimit të korrierëve) i cili organizon dorëzimin respektivisht tërheqjen e çmimeve.

### **Neni 10. Ndarja e çmimeve**

Çmimet do të ndahen në afat jo më të gjatë se 60 ditë nga publikimi i fituesve. Pas skadimit të këtij afati, Organizatori nuk ka asnjë përgjegjësi për mos tërheqjen eventuale të çmimeve të ndara.

Fituesit e çmimeve do të duhet të lënë të dhënat e përshkruara më poshtë në këto rregulla të nevojshme për dorëzimin e çmimit në mikrosajt [www.naracajpodarok.mk](http://www.naracajpodarok.mk), jo më vonë se deri më 15.09.2026:

Të dhënat e nevojshme për çmimet (Top futbollit, Çantë sportive, Bluzë, Çantë ftohëse, Kufje, Altoparlantë) janë:

- emri dhe mbiemri
- numri i telefonit
- e-postë/ adresë e-mail
- vendndodhja e Tehnomarket-it ku dëshiron të tërheqë çmimin
- kodi unik i çmimit

Të dhënat e nevojshme për çmimet (TV Hisense) janë:

- emri dhe mbiemri
- numri i telefonit

- e-postë/ adresë e-mail
- adresa e dorëzimit të çmimit
- qyteti
- kodi unik i çmimit
- NUMRI PERSONAL për shkak të vlerës së çmimit mbi 5000 denarë.

Të dhënat e nevojshme për çmimet (Mini frigorifer, Altoparlant Marshall) janë:

- emri dhe mbiemri
- numri i telefonit
- e-postë/ adresë e-mail
- kodi unik i çmimit
- vendndodhja e Tehnomarket-it ku dëshiron të tërheqë çmimin
- NUMRI PERSONAL për shkak të vlerës së çmimit mbi 5000 denarë.

Të gjithë fituesit e çmimeve, do të marrin mesazh konfirmues në vetë aplikacionin, me kodin unik të çmimit dhe lidhjen me mikrosajtin [www.naracajpodarok.mk](http://www.naracajpodarok.mk) ku duhet të lënë të dhënat e nevojshme me qëllim organizimin e dorëzimit të çmimit në adresën e dorëzimit, respektivisht tërheqjes.

Organizatori autorizon Porositësin dhe Tehnomarket-in për organizimin operativ, evidencën dhe realizimin e tërheqjes së çmimeve nga pikat e shitjes së Tehnomarket-it, përfshirë edhe identifikimin e fituesve dhe lëshimin e konfirmimeve të fitimit në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Organizatori nuk ushtron kontroll të drejtpërdrejtë mbi procesin e tërheqjes së çmimeve, por ka të drejtë të shqyrtojë gjithë dokumentacionin dhe evidencën me qëllim përmbushjen e detyrimeve të tij ligjore.

Të gjitha kërkesat eventuale, ankesat ose mosmarrëveshjet e lidhura me tërheqjen e çmimeve nga pikat e shitjes së Tehnomarket-it, fituesit i realizojnë drejtpërdrejt ndaj Porositësit dhe/ose Tehnomarket-it, të cilët janë përgjegjës për organizimin dhe realizimin e këtyre aktiviteteve, përfshirë edhe për mosmarrjen, marrjen me vonesë ose mangësitë eventuale të lidhura me dorëzimin e çmimeve.

Porositësi dhe Tehnomarket-i janë të detyruar të hartojnë raport me shkrim një herë në javë për të gjitha çmimet e dorëzuara, i cili do t'i dërgohet Organizatorit, me qëllim llogaritjen dhe pagesën në kohë të tatimit mbi të ardhurat nga çmimet e fituara në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm, llogaritjen dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga çmimet e fituara në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm.

Fituesit çmimet do t'i mund të tërheqin drejtpërdrejt në pikat e shitjes së Tehnomarket-it me paraqitjen e kodit nga vauçeri me vlerë që do ta marrin në version elektronik në adresën e tyre të e-postës, të cilin do ta fusin në mikrosajtin [www.naracajpodarok.mk](http://www.naracajpodarok.mk) dhe paraqitjen e kartës së identitetit për shqyrtim për qëllime të identifikimit të tyre, pas kalimit të 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve të llogaritura nga dita e futjes së të dhënave në mikrosajtin [www.naracajpodarok.mk](http://www.naracajpodarok.mk) ose jo më vonë se deri më 26.10.2026.

Pjesëmarrësi do të duhet të fusë të dhënat e mëposhtme: emri, mbiemri, vendndodhja e Tehnomarket-it për tërheqje, numri i telefonit të kontaktit, e-posta dhe kodi unik i çmimit.

Nëse fituesit nuk fusin të dhënat e nevojshme ose nuk fusin të dhëna të sakta për tërheqjen e çmimit, do të konsiderohet se nuk dëshirojnë ta tërheqin çmimin, ndërsa Organizatori nuk do të

konsiderohet përgjegjës për asnjë arsye. Gjithashtu, për çmimet kryesore do të kalohet në ndarjen e fituesit tjetër rezervë. do të kalohet në ndarjen e fituesit tjetër rezervë.

Në rast të dorëzimit të të dhënave personale jo të plota ose jo të sakta, çmimi nuk do të mund të tërhiqet.

Në rast se dorëzohen të dhëna jo të plota ose jo të sakta ose të dhëna të një personi që nuk është madhor, çmimi nuk do të jepet.

Në rast se një person minoren fut të dhëna jo të sakta ose të rreme në lidhje me moshën e tij, kundër rregullave të lojës shpërblyese dhe në këtë mënyrë merr pjesë ose zgjidhet si fitues, Organizatori nuk mban asnjë përgjegjësi në lidhje me mospagesën e çmimit.

Personat minoren nuk kanë të drejtë ta tërheqin çmimin, por nëse çmimi dërgohet me postë elektronike dhe pranohet nga një person minorenë, përgjegjësia e plotë për përdorimin e tij dhe pasojat e mbart përfaqësuesi i tij ligjor, ndërsa Organizatori nuk mban asnjë përgjegjësi.

Fituesit nuk mund t'i shkëmbejnë çmimet e tyre me shumë monedha të barabartë me vlerën e tyre, as me ndonjë send tjetër. Vlera e çmimit nuk është e ndashme dhe shfrytëzohet menjëherë në tërësi.

Pas skadimit të 60 ditëve nga shortimi i fundit, Organizatori nuk ka asnjë përgjegjësi në lidhje me çmimet. Në rast se nuk ka pjesëmarrës të mjaftueshëm të regjistruar për të ndarë çmimet e planifikuara – çmimet mbeten të pandara dhe i mbeten Porositësit të lojës shpërblyese (Birraria e Shkupit SHA).

### **Neni 11. E drejta e ankesës**

Çdo pjesëmarrës ka të drejtë të paraqesë ankesë për rrjedhën e lojës shpërblyese te Organizatori brenda 5 (pesë) ditëve nga publikimi i fituesve në ueb faqen dhe Organizatori do t'i përgjigjet ankesës brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së saj.

### **Neni 12. Mospërputhja**

Në rast të gabimeve të shtypit në materialet reklamuese ose mospërputhjes së fotografive të çmimeve me pamjen e tyre reale, Organizatori, respektivisht Porositësi nuk do të konsiderohet përgjegjës.

### **Neni 13. Përgjegjësia**

Organizatori dhe Porositësi nuk kanë asnjë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga ose në lidhje me realizimin e kësaj loje shpërblyese (fitim real ose i humbur), ndaj cilido person të tretë, përveç nëse dëmi i tillë nuk ka ardhur si pasojë e drejtpërdrejtë e fajit të Organizatorit, respektivisht Porositësit.

Përgjegjësia e Organizatorit respektivisht Porositësit

- Organizatori do të jetë përgjegjës deri në realizimin e plotë të çmimeve, respektivisht deri në tërheqjen e çmimeve ose jo më vonë se 60 ditë nga dita e përfundimit të lojës shpërblyese.
- Me pagesën e tatimit personal (për çmime me vlerë mbi 5.000 denarë) dhe marrjen e çmimeve, pushojnë detyrimet e mëtejshme të Organizatorit të lojës shpërblyese ndaj fituesve.
- Organizatori, respektivisht Porositësi, nuk ka asnjë përgjegjësi që mund të rrjedhë nga përdorimi i çmimeve, si dhe pagesa e dëmeve të cilat në ndonjë mënyrë janë të lidhura me përdorimin e çmimit.
- Organizatori, respektivisht Porositësi, nuk merr përgjegjësi në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet pjesëmarrësve në lojën shpërblyese në lidhje me pronësinë e kapakëve ose hapësve të kanaçeve me kode nga paketimet e listuara në nenin 2 të këtyre Rregullave.
- Organizatori, respektivisht Porositësi nuk merr përgjegjësi për funksionalitetin e aplikacionit, sistemit dhe mekanizmit nëpërmjet të cilit do të zhvillohet loja shpërblyese, ndarja, dorëzimi dhe marrja e çmimeve dhe vauçerëve të çmimeve. Për pengesa eventuale teknike të herëpashershme dhe ndërprerje të punës së aplikacionit Coca-Cola, përgjigjet kompania NV Coca-Cola Services SA e vendosur në adresën e mëposhtme Chaussée de Mons 1424, 1070 në Bruksel, në pronësi të së cilës është aplikacioni. Organizatori i lojës shpërblyese nuk jep garanci se pjesëmarrësi do të fitojë çmim nëse shpenzon shumë më të madhe parash.
- Organizatori nuk mban përgjegjësi në rast kur çmimi i fituar nuk mund të jepet ose shfrytëzohet për shkak të pamundësisë së fituesit potencial ose përfaqësuesit të tij të paraqitet dhe ta marrë çmimin brenda afateve të caktuara ose për shkak të pengesave të tjera teknike ose ligjore të lidhura me fituesin konkret ose përfaqësuesin e tij dhe për shkak të rrethanave të shkaktuara nga forca madhore, kufizimeve normative ose ligjore ose rrethanave të tjera.
- Shortimi i çmimeve me zgjedhje rastësore do të kryhet nga NTH Media Maqedoni SHPKNJP Shkup dhe "MMS Komunikacii Makedonija DOO Skopje". Qendra e të dhënave e NTH Media Maqedoni SHPKNJP Shkup është e vendosur në adresën e mëposhtme Hardtrumstrasse 161, 8005 Cyrih, Zvicër.
- I gjithë fondi i çmimeve do të sigurohet nga Porositësi (Birraria e Shkupit SHA). Birraria e Shkupit SHA Shkup, NTH Media Maqedoni SHPKNJP Shkup dhe Vorhol SHPKNJP Shkup do të jenë persona të autorizuar për përpunimin e të dhënave personale të lidhura me realizimin e kësaj loje shpërblyese. Personat e autorizuar do të nënshkruajnë me dorën e tyre edhe Deklaratë mbi fshehtësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### Pëlqimi i pjesëmarrësit

- Pjesëmarrësi potencial në këtë lojë shpërblyese kupton dhe pranon se merr pjesë në lojën me shpërblyese me rrezikun e tij të vetë. Me vetë pjesëmarrjen në lojën me çmime, pjesëmarrësi pranon që, nëse fiton ndonjë çmim, adresa e tij e e-postës me të cilën është regjistruar në aplikacion (me 5 karaktere të fshehura) dhe çmimi që ka fituar, të publikohen publikisht në ueb faqen [www.coca-cola.mk](http://www.coca-cola.mk) dhe në aplikacionin Coca-Cola.

## **Neni 14. Miratimi i përpunimit të të dhënave personale**

Fituesit e **çmimeve** pranojnë që gjatë tërheqjes së çmimit të kryhet shqyrtimi i kodit fitues dhe kartës së identitetit të fituesve, me qëllim identifikimin e tyre dhe vërtetimin e të drejtës së pjesëmarrjes në lojën me çmime, respektivisht nëse personi është madhor. Fituesit pranojnë të dorëzojnë të dhënat e mëposhtme: kodin unik të çmimit, emrin, mbiemrin, e-postën, numrin e telefonit të kontaktit dhe NUMRIN PERSONAL, në mikrosajt [www.naracajpodarok.mk](http://www.naracajpodarok.mk).

Nëse fituesi i çmimit nuk është person madhor, nuk do t'i mundësohet të marrë çmim si shkëmbim i barkodit fitues.

Fituesi i **çmimit me vlerë mbi 5000 denarë** pranon të dorëzojë të dhënat e mëposhtme: kodin unik të çmimit, emrin dhe mbiemrin, adresën e e-mailit dhe numrin e telefonit, adresën e dorëzimit dhe NUMRIN PERSONAL, me qëllim ndarjen e çmimit. Fituesit e çmimeve me vlerë mbi 5000 denarë duhet të japin edhe NUMRIN E TYRE PERSONAL në mënyrë që Organizatori të kryejë në emër të tyre pagesën e tatimit personal për çmimin e fituar, respektivisht të plotësojë detyrimin ligjor.

Qëllimi i përdorimit dhe transferimit të të dhënave nga ana e Organizatorit është ekskluzivisht të ndihmojë në zbatimin dhe administrimin e pjesëmarrjes në lojën me çmime dhe pagesën e detyrimeve tatimore në lidhje me të. Organizatori do t'i përdorë dhe përpunojë të dhënat personale të fituesve ekskluzivisht për qëllimet e Lojës shpërblyese dhe atë për identifikimin e fituesit, për verifikimin e të drejtës së pjesëmarrjes në lojën me çmime dhe për dorëzimin e çmimit dhe shqyrtimi i kartës së identitetit është i nevojshëm për vërtetimin e të drejtës së pjesëmarrjes në lojën me çmime.

Subjektet të cilët do të realizojnë vauçerët gjatë shqyrtimit të tyre duhet të konfirmojnë identitetin e fituesit. Për atë qëllim, fituesit mund t'i kërkohet dokument identifikimi personal për shqyrtim.

Nga ana e "MMS Komunikacii Makedonija DOO Skopje", Birrarisë së Shkupit SHA Shkup, NTH Media Maqedoni SHPKNJP Shkup dhe Vorhol SHPKNJP Shkup do të caktohen persona të autorizuar për përpunimin e të dhënave personale të lidhura me realizimin e kësaj loje me çmime. Personat e autorizuar do të nënshkruajnë me dorën e tyre edhe Deklaratë mbi fshehtësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Organizatori i lojës shpërblyese merr përsipër se nuk do t'i dërgojë të dhënat personale palëve të treta, përveç nëse kjo është e nevojshme për zbatimin e lojës shpërblyese në pajtim me ligjin.

Organizatori i lojës shpërblyese merr përsipër se të dhënat personale do t'i përpunojë dhe ruajë në periudhë prej 3 muajsh pas përfundimit të lojës shpërblyese dhe se gjatë kësaj periudhe do të zbatohet masa teknike dhe organizative të cilat do të sigurojnë shkallë të duhur të fshehtësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave personale. Pas kësaj do t'i asgjësojë ato në pajtim me procedurat e tij për asgjësimin e dokumenteve, sipas dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale.

Aplikacioni është në pronësi të kompanisë NV Coca-Cola Services SA e me seli në adresën e mëposhtme Chaussée de Mons 1424, 1070 në Bruksel. Qendra e të dhënave e kompanisë NV Coca-Cola Services SA ndodhet në Amazon Web Services Ireland Region me entitetin Amazon Web Services Inc në adresën 440 Terry Ave N, Seattle, WA 98109.

Qendra e të dhënave e qendrës së kontaktit NTH Media Maqedoni SHPKNJP Shkup është e vendosur në adresën e mëposhtme Hardtrumstrasse 161, 8005 Cyrih, Zvicër.

Qendra e të dhënave e shërbimit Microsoft Azure e cila do të merret me qira për vendosjen e bazës dhe hostimin e faqes web [www.naracajpodarok.mk](http://www.naracajpodarok.mk) ndodhet në Cyrih, Zvicër.

### **Neni 15. Ndërprerja e lojës shpërblyese**

Loja shpërblyese mund të ndërpritet në rast të forcës madhore, në pajtim me nenin 9 të Ligjit për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese, duke përfshirë pamundësinë e Organizatorit për të zhvilluar lojën me çmime për arsye të pavarura nga vullneti i tij. Në këtë rast, Organizatori, pas njoftimit dhe marrjes së miratimit nga Ministria e Financave, duhet t'i informojë konsumatorët për ndërprerjen e lojës shpërblyese, për arsyet e ndërprerjes dhe datën e ndërprerjes nëpërmjet njoftimit në media.

### **Neni 16. Mosmarrëveshjet potenciale**

Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Organizatorit dhe pjesëmarrësve të lojës shpërblyese, kompetente është Gjykata Themelore Civile Shkup në Shkup.

### **Neni 17. Rregullat e detyrueshme**

Këto rregulla zyrtare janë të vlefshme nga dita e miratimit të tyre, dhe do të fillojnë të zbatohen pasi Ministria e Financave të lëshojë Lejen për organizimin e lojës së fatit – lojës shpërblyese dhe do të jenë të vlefshme deri në përfundimin e lojës shpërblyese. Me pjesëmarrjen në lojën me çmime, çdo pjesëmarrës pranon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e vendosura në këto rregulla.

Të gjithë të interesuarit mund të marrin kopje të rregullave të lojës shpërblyese me shpenzimet e tyre nga zyrat e "MMS Komunikacii Makedonija DOO Skopje".

Për informacione shtesë, pjesëmarrësit mund të telefonojnë në numrin e telefonit 02/3207 751 çdo ditë pune nga ora 9:00 deri në orën 17:00, në periudhën nga 18.05.2026 deri më 26.8.2026.

### **Organizatori**

**"MMS Komunikacii Makedonija DOO Skopje/MMS Komunikime Maqedoni SHPK Shkup"**